



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

---


Nr. 05/72  
Datë: 29.01.2016

Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjësisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren nr. 07/2011 dhe nenit 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës nr. 09/2011, në mbledhjen e mbajtur më 29 Janar 2016, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

1. Aprovohet Koncept Dokumenti për Përmirësimin e Kornizës Ligjore për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe institucionet tjera kompetente për zbatimin e këtij vendimi, në pajtim me Rregulloren e Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

**Isa MUSTAFA**

  
Kryeministër i Republikës së Kosovës

**Iu dërgohet:**

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**  
*Qeveria - Vlada - Government*

*Ministria e Financave*  
*Ministarstvo Finansija - Ministry of Finance*

---

**KONCEPT DOKUMENTI PËR  
PËRMIRËSIMIN E KORNIZËS LIGJORE PËR  
SISTEMIN E KONTROLLIT TË BRENDSHËM TË  
FINANCAVE PUBLIKE**

## Përmbajtja

Hyrje .....	3
2. Përshkrimi dhe përkufizimi i çështjes / problemit kryesor .....	4
3. Synimet dhe objektivat .....	8
4. Opsionet për kornizën ligjore .....	11
5. Arsyeja e propozimit (analiza e opsionit) .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
6. Elementet kyçe të politikës së propozuar .....	<b>Error! Bookmark not defined.</b>
7. Pasojat e të gjitha opsioneve të konsideruara.....	16
8. Vlerësimi i ndikimit financiar për secilin propozim .....	16
9. Konsultimet .....	17
10. Mënyra e komunikimit të politikës së re në publik.....	17

## Hyrje

Qeveria e Republikës së Kosovës, në prill të vitit 2015 ka miratuar Strategjinë e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike (KBFP) 2015 - 2019. Strategjia i përcakton objektivat dhe veprimet për zhvillim të mëtejshëm të sistemit të KBFP-së, i përbërë nga Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli, dhe Auditimit të Brendshëm. Krijimi i kornizës ligjore adekuate është një veprim me prioritet i përcaktuar nga Strategjia e KBFP-së dhe do të mundësoj arritjen e objektivave të Strategjisë.

Koncepti i kontrollit të brendshëm të financave publike (KBFP) është zhvilluar nga Komisioni Evropian me qëllim të përkrahjes të vendeve candidate dhe ato potencialisht candidate për reformimin e sistemit të tyre në menaxhimin dhe kontrollimin e fondeve publike. Qëllimi kryesor i sistemit të KBFP-së ishte ofrimi i kushteve për menaxhim efikas dhe në pronësi të fondeve të BE-së, por meqë këto fonde janë gjithnjë e më tepër pjesë përbërëse e buxheteve kombëtarë, sistemi i KBFP-së vlen edhe për çdo fond dhe pasuri publike pa përjashtim.

Marrëveshja e Stabilizim Asocimit (MSA) në mes të Qeverisë së Kosovës dhe BE-së, e filluar në korrik të vitit 2014, në nenin 97 specifikon *"Në veçanti Palët do të bashkëpunojnë me qëllim të zhvillimit të mëtejshëm të zbatimit të kontrollit efikas të brendshëm dhe sistemit funksionalisht të pavarur të auditimit të brendshëm në sektorin publik në Kosovë, në përputhje me kornizën e pranuar ndërkombëtarisht dhe praktikën e mira të BE-së"*. Raporti i Progresit i KE-së për vitin 2015 e konsideron Strategjinë e KBFP-së 2015-2019 si një hap i rëndësishëm në përmbushjen e kushteve të Kapitullit 32 Kontrolli Financiar dhe rekomandon në përafrimin e kornizës ligjore në përputhje me standardet ndërkombëtare për kontrollin e brendshëm dhe Standardet Ndërkombëtare për Praktikë Profesionale të Auditimit të Brendshëm (SNPPAB).

Kosova, pritet të marrë mbështetje të konsiderueshme buxhetore nga Bashkimi Evropian. Aprovimi i dokumenteve sektoriale të veprimit për përkrahje buxhetore dhe transferimet e fondeve të BE-së bëhen sipas kontrolleve rigorozë të menaxhimit të financave publike, përfshirë kontrollet e brendshme, auditimin e brendshëm dhe të jashtëm. Andaj, zbatimi i kornizës ligjore adekuate të KBFP-së do të kontribuoj në masë të madhe përmbushjen e kriterëve për përkrahje me buxhet dhe avancimin e përgjithshëm të llogaridhënies në procesin e menaxhimit të financave publike.

Aktualisht, elementet e KBFP-së rregullohen me tre akte ligjore të ndryshme: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP), Ligji për Auditimin e Brendshëm (LAB) dhe Rregulla Financiare e Thesarit 01/2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll. Lidhur me kërkesën për menaxhim të përgjegjshëm, efikas të fondeve publike, dispozitat nuk mbulojnë në mënyrë sistematike të gjitha çështjet e KBFP-së dhe në veçanti llogaridhënien e secilit akterë dhe menaxhimin e rrezikut.

Qëllimi i këtij koncept dokumenti është prezantimi i opsioneve të mundshme dhe rekomandimi i opsionit të preferuar për përmirësimin dhe rregullimin e sistemit të kontrollit të brendshëm të financave publike dhe ngritja e llogaridhënës. Me këtë do të rregullohen të gjitha komponentët e KBFP-së, do të harmonizohet legjislacioni kombëtar me legjislacionin e BE-së dhe do të sigurohet funksionim efikas i këtij sistemi në sektorin publik të Kosovës.

## 2. Përshkrimi dhe përkufizimi i çështjes /problemit kryesor

### 2.1. Shpjegim

*Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike (KBFP), si koncept i përgjithshëm i cili po zhvillohet në linjë me kërkesat e Komisionit Evropian, lidhur me Kapitullin 32 Kontrolli Financiar, përbëhet nga tri elemente; Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli (MFK), Auditimi i Brendshëm (AB) dhe Njësia Qendrore Harmonizuese (NJQH).*

Kontrolli i Brendshëm i Financave Publike që përfshin Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, Auditimin e Brendshëm dhe Njësinë Qendrore Harmonizuese, aktualisht rregullohet me tri akte të ndryshme ligjore:

- Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (LMFPP) nga viti 2008, i ndryshuar në vitin 2013
- Ligjin për Auditimin e Brendshëm (LAB) nga viti 2009, dhe
- Rregulla Financiare e Thesarit 01/2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll, nga viti 2010.

Këto akte ligjore kanë këto mangësi:

- Mosbalancimin në ndarjen e kompetencave dhe detyrave në mes të akterëve kyç në procesin e Menaxhimit të Financave Publike;
- Mungesën e kërkesave adekuate ligjore për zhvillimin e pesë komponentëve të kontrollit të brendshëm, përkatësisht (1) mjedisit të kontrollit, (2) menaxhimin e rrezikut, (3) veprimtarive të kontrollit, (4) informimin dhe komunikimin, dhe (5) monitorimin;
- Mungojnë kontrollet themelore dhe llogaridhënia për menaxhimin e pasurive dhe detyrimeve në sektorin publik (Pasqyra e gjendjes financiare);
- Llogaridhënia menaxheriale nuk përkrahet me dispozita adekuate për delegimin e kompetencave dhe raportimin tek niveli më i lartë i autoritetit;
- Mungesa e dispozitave për menaxhimin e parregullsive, dispozitave për përgjegjësi, dhe sanksione në rast të shkeljeve ligjore dhe mashtrimeve;
- Ligji i auditimit të brendshëm, nuk është në pajtim në disa aspekte me standardet e aplikueshme profesionale ndërkombëtare, është në pajtueshmëri me disa akte ligjore vendore si p.sh., Ligjin për Ndërmarrjet Publike<sup>1</sup> dhe LMFPP. Neni 2 dhe 10 i Ligjit mbi Auditimin e Brendshëm obligon të gjitha subjektet e sektorit publik të Kosovës, veprimtaria e të cilave mbështetet në pronën publike që të zbatojnë auditimin e brendshëm në pajtim me kërkesat e këtij ligji. Ndërsa neni 38.2 Ligjit nr. 03/1-087 për Ndërmarrjet Publike përjashton zbatimin e Ligjit për Auditim për ndërmarrjet publike. Nenin 6 a i Ligjit për MFPP i ndryshuar në vitin 2013, përcakton themelimin e NjQH e cila duhet të përbëhet nga dy njësi: Njësinë Qendrore për Harmonizimin e Auditimit të Brendshëm, dhe Njësinë Qendrore Harmonizuese për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll, ndërsa neni 7 Ligjit të Auditimit përcakton themelimin e vetëm NjQHAB.
- Funkzioni i Auditimit të Brendshëm nuk është i organizuar në mënyrë efikase dhe dispozitat ligjore nuk e garantojnë cilësinë e kërkuar të këtij profesioni. Meqë një numër i njësive të auditimit të brendshëm kanë vetëm nga një

<sup>1</sup> Ligji për Ndërmarrjet Publike Nr. 03/L-087 dhe Nr. 04/L-111)

auditor të brendshëm, që nuk garanton cilësinë dhe objektivitetin e kryerjes së shërbimit të auditimit.

Ka pasur gjithashtu ndryshime në standardet e pranuar ndërkombëtarisht për kontrollin e brendshëm dhe së fundi edhe në auditimin e brendshëm të cilat duhet reflektuar në legjislacion si në vijim:

- Standardet ndërkombëtare të Kontrollit - Korniza e Integruar e Kontrollit të Brendshëm, COSO (Komiteti për Sponsorizimin e Organizatave -Treadway), përditësuar më 2013
- Standardet Ndërkombëtare për Praktikë Profesionale të Auditimit të Brendshëm (SNPPAB), përditësuar më 2009, 2011, 2013 dhe 2015.

Kohëzgjatja e problemi ka ekzistuar qysh nga hyrja në fuqi e Ligjit për ndërmarrjet publike Nr. 03/L-087, 2008, ndryshim plotësimit të Ligjit për MFPP në vitin 2013 dhe Rregullës së Thesarit Nr 01/2010 për menaxhimin financiar dhe kontrollit në vitin 2010

## 2.2. Legjislacioni në fuqi

Legjislacioni në fuqi për rregullimin e kontrollit të brendshëm të financave publike është: Ligji për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësit (LMFPP), Rregulla Financiare e Thesarit 01/2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll; Ligji për Auditimin e Brendshëm, Ligji për Ndërmarrjet Publike, aktet tjera ligjore që rregullojnë përgjegjësinë e udhëheqësve të subjekteve të sektorit publik (SPP), zyrtarëve kryesorë administrativ (ZKA), zyrtarëve kryesor financiar (ZKF).

**LMFPP** - rregullon përgatitjen dhe aprovimin e buxhetit, realizimin e buxhetit, kontabilitetin dhe raportimin financiar, mirëpo ky ligj nuk përfshin fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollin sipas kornizës "COSO" (Komiteti për Sponsorizimin e Organizatave -Treadway), si përcaktimin e objektivave, ndarjen e detyrave, menaxhimin e rrezikut, raportimin. Gjithashtu nuk përcakton në mënyrë të qartë llogaridhënies menaxheriale dhe funksionet e NJQH.

**Rregulla Financiare e Thesarit 01/2010 për Menaxhimin Financiar dhe Kontroll** - është akt nënligjor me të cilin rregullohet menaxhim financiar dhe kontrolli. Meqë, menaxhimi financiar dhe kontrolli, rregullohet vetëm me këtë akt nënligjor e jo me akt ligjor ka bërë që kjo të mos jetë prioritet i menaxhimentit të lartë të sektorit publik dhe nuk ka gjet zbatim adekuat. Edhe pse kjo rregull kërkon që subjekti i sektorit publik të menaxhoj rrezikun duke krijuar edhe regjistrin e rrezikut ende shumica e subjekteve të sektori publik nuk i kanë krijuar regjistrat e rrezikut.

**Ligji për Auditimin e Brendshëm** - nuk i përcakton aranzhimet e sigurimit të cilësisë në linjë me SNPPAB (Standardet ndërkombëtarë për praktikë profesionale për auditim të brendshëm) dhe rekomandimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Buxhetit të Komisionit Evropian, në këtë aspekt nuk i shërben qëllimit të funksionit të auditimit të brendshëm për të qenë si shërbim këshillëdhënës për menaxhimentin në linjë me SNPPAB. Interpretimi i auditimit të brendshëm vetëm si funksionin "i

brendshëm" e ka dëmtuar zhvillimin e ekipeve me shkathtësi profesionale të aftë për të audituar fushat me rrezik të lartë dhe ka qar në shtimin e njësive me nga një auditor të vetëm në kundërshtim me përkufizimin e auditimit të brendshëm.

Gjithashtu është edhe legjislacioni sekondar që përbëhet nga Doracaku i procedurave të MFK-së që nga viti 2011, me 14 procedura që për synim kanë përfshirjen e të gjitha fushave të ciklit buxhetor. Doracaku nuk është zbatuar në mënyrë adekuate dhe të kënaqshme, meqë i mungojnë mjetet për të punuar me procedurat apo nuk i referohet procedurave universale sikur të automatizuara në softuerin e Buxhetit dhe Thesarit.

#### **Rregulloret sekondare për auditimin e brendshëm përfshijnë:**

- Udhëzimi Administrativ nr. 22/2009 për Përcaktimin e Kritereve dhe Procedurave e pajisjes me Licencë të Përkohshme të Auditorëve të Brendshëm në Sektorin Publik, dhjetor 2009
- Udhëzimi Administrativ nr. 23/2009 për Themelimin dhe Funksonimin e Njësive të Auditimit të Brendshëm në Sektorin Publik, dhjetor 2009
- Udhëzimi Administrativ nr.11/2010 për Themelimin dhe Funksonimin e Komitetit të Auditimit në Subjektet e Sektorit Publik
- Udhëzimi Administrativ nr. 05/2012/MF për Procedurën e Pajisjes me Licencë Profesionale të Auditorëve të Brendshëm në Sektorin Publik, janar 2013
- Doracaku i Auditimit të Brendshëm, i nxjerrë më 2008, i rishikuar më 2011

Shumica e dispozitave në Udhëzime Administrative kanë nevojë për përditësim për të pasqyruar zhvillimet në profesion, për të përmirësuar cilësinë e auditimit dhe proporcioni kosto / përfitim nga ky shërbim.

Përveç kësaj, ka pasuri dhe fonde publike që nuk mbulohen me legjislacionin lartpërmendur dhe sidomos pasurit dhe fondet e Ndërmarrjeve Publike (NP-ve). Pasuria (e luajtshme dhe paluajtshme) e cila menaxhohet nga ndërmarrjet publike është pronë publike ku pronar është Qeveria ose Komunitat, pasi që aksionar të vetëm të ndërmarrjeve publike janë Qeveria dhe komunitat. Gjithashtu ndërmarrjet publike menaxhojnë edhe me fondet që sigurohen me bashkëfinancim dhe nga donatorët, të cilat duhet të menaxhohen në pajtim me LMFPF dhe auditohen sipas LAB. Meqë legjislacioni i veçantë për ndërmarrjet publike nuk rregullon menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe përjashton zbatimin e auditimit të brendshëm sipas kërkesave të Ligjit të auditimit të brendshëm, është rrezik potencial për të gjeneruar borxhe publike dhe keq menaxhim të pasurive dhe fondeve publike.

#### *2.4. Shpenzimet aktuale*

Kategoria e shpenzimeve	Shpenzimet në vitin paraprak 2014	Buxheti Aktual	Buxheti për 2016	Buxheti për 2017	Buxheti për 2018
Buxheti i MF-së (DPT) Pagat dhe mëditjet	77,774	125,396	132,711	132,711	132,711

- Trajnimet për auditorët e brendshëm	78,124	78.124	79,757	79,757	79,757
Financimi nga donatorët (Trajnimi në CIPFA paguar nga projekti i financuar nga BE)					
Shpenzimet tjera direkte të MF-së					
<b>Gjithsej</b>	<b>155,898</b>	<b>203,520</b>	<b>212,468</b>	<b>212,468</b>	<b>212,468</b>

Zbatimi i Ligjit të KBFP nuk do të ketë kërkesa për buxhet shtesë sepse buxheti për aktivitetet që dalin nga ky ligj janë të përfshira në kornizën afatmesme të shpenzimeve në pajtim me kërkesat që dalin nga LMFPP dhe LAB.

## 2.5. Përvojat nga vendet tjera

Praktika e vendeve kandidate, dhe potencialisht kandidate, shtetet e reja anëtare dhe Politika Evropiane për Fqinjësi të vendeve është se dispozitat e KBFP-së janë vendosura në një ligj të veçantë, e jo si pjesë e ligjit organik (bazik) buxhetor.

Vendet potencialisht kandidate dhe kandidate kur fillojnë më zbatimin e KBFP-së kanë sisteme buxhetore të orientuara drejt inputit. Në raste të tilla, mishërimi i dispozitave të KBFP-së në ligjin organik buxhetor rrezikon që KBFP do të konsiderohet vetëm si “kontrolle inputi” shtesë, ndërsa të gjitha segmentet tjera të rëndësishme për zhvillimin e përgjithshëm të KBFP-së siç është caktimi i objektivave dhe lidhja e objektivave me burimet buxhetore, menaxhimin e rrezikut, ngritjen organizative të subjekteve të sektorit publik, linjat e llogaridhënies në mes të organizatave të ndërlidhura buxhetore, etj., mund të qëndrojnë në hije.

Në mënyrë që të sigurohet bazë e fortë ligjor për zbatimin e përgjithshëm dhe të harmonizuar të të gjitha tri komponentëve të KBFP-së dhe fuqizimin e Ministrisë së Financave dhe NJQH-së në shtyrjen e ndryshimeve, është e dobishme që të kemi ligj të veçantë të KBFP-së.

**Tabela 1: Analizë krahasuese e kornizës ligjore të KBFP-së në vendet tjera**

Dispozitat ligjore të KBFP-së	Vendi	Titulli i Ligjeve
1. Dispozitat e KBFP-së të cilat	Shqipëri	Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolli Ligji për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik



rregullohen ndarazi me Aktin Organik të Buxhetit	BeH	Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrolli <i>(në procedurë të miratimit nga Parlamenti që nga shtatori i vitit 2014)</i>
	Bullgari	Ligji për Auditimin e Brendshëm Akti për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin Akti për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik
	Republika Çeke Kroaci	Akti për Kontrollin Financiar Ligji për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike
	Lituani	Ligji për Kontrollin e Brendshëm dhe Auditimin e Brendshëm
	Maqedoni	Ligji për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike
	Mali i Zi	Ligji për Sistemin e Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike
	Sllovaki	Akti për Kontrollin Financiar
	2. Dispozitat e MFK-së të përfshira në Aktin Organik të Buxhetit/ Aktin e Financave Publike, dispozitat e AB-së të rregulluara ndarazi	BeH <i>Niveli shtetëror</i>
Qipro		Ligji për Menaxhimin e të Hyrave dhe Shpenzimeve dhe i Sistemit të Kontabilitetit <i>(përfshirë dispozitat e MFK-së)</i>
Estoni		Ligji për Auditimin e Brendshëm Akti për Buxhetin Shtetëror <i>(përfshirë dispozitat e MFK-së)</i> Akti i Qeverisë <i>(përfshirë dispozitat e AB-së)</i>
Letoni		Ligji për Buxhet dhe Menaxhimin Financiar <i>(përfshirë dispozitat e MFK-së)</i> Ligji për Auditimin e Brendshëm
Rumani		Ligji për Financat Publike <i>(përfshirë dispozitat e MFK-së)</i> Ligji për Auditimin e Brendshëm Publik
3. Dispozitat e KBFP-së të përfshira në Aktin Organik të Buxhetit/ Akti i Financave Publike		Hungari
	Poloni	Akti për Financat Publike
	Serbi	Ligji për Sistemin e Buxhetit
	Slloveni	Akti për Financat Publike

**Burimi:** Raportet e vlerësimit të SIGMA-së për vendet candidate dhe vendet e mundshme candidate dhe Përmbledhja e Komisionit Evropian e Sistemit të Kontrollit të Brendshëm Financiar në Shtetet Anëtare të BE-së 2012, dhe botimi i dytë 2014

### 3. Synimet dhe objektivat

Qëllimi i përgjithshëm i reformës së KBFP-së është të përmirësojë përputhshmërinë, efikasitetin, efektivitetin dhe ndershmërinë e menaxhimit të fondeve publike dhe të sigurojë arritjen e objektivave strategjike të Qeverisë së Kosovës.

Strategjia e KBFP-së i ka katër objektiva. Legjislacioni i KBFP-së duhet të përmbaj dispozita që lejojnë arritjen e tyre.

1. *Kontrollet mbi inputet dhe burimet, integrohen në sistemin dhe proceset e menaxhimit të financave publike deri më 2017;*
2. *Ekziston llogaridhënie menaxheriale për inputet dhe menaxhimin e burimeve, e vërtetuar nga raportet e përgatitura nga menaxherët e fondeve publike deri më 2017 - 2018;*
3. *Ekziston menaxhim i rrezikut në çdo organizatë buxhetore, i verifikuar nga strukturat dhe raportet e menaxhimit të rrezikut deri më 2017;*
4. *Funksioni i auditimit të brendshëm shton vlerën menaxhimit llogaridhënës duke ofruar siguri të përqendruar në rrezik dhe shërbime këshillimore, të vërtetuara nga tregues ekonomik, efikas dhe efektiv deri më 2019.*

Me politikën e re mbi kontrollin e brendshëm të financave publike synohet të arrihen këto objektiva:

1. Krijimin e bazës ligjore për zbatimin e përgjithshëm dhe të harmonizuar të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike.
2. Ngritjen e llogaridhënies menaxheriale për shfrytëzimin e fondeve dhe pasurive publike si dhe përmirësimin e pajtueshmërisë dhe efikasitetit të shpenzimeve publike.
3. Fuqizimin e rolit të Njesisë Qendrore Harmonizuese dhe funksionimi i pavarur i auditimit të brendshëm si mjet që i shton vlerën menaxhimentit në arritjen e objektivave

Legjislacioni primar që rregullon menaxhimin financiar dhe kontrollin do të siguroj:

- Përcaktimin e llogaridhënies menaxheriale si shytës kryesor për përmirësimin e pajtueshmërisë dhe efikasitetit të shpenzimit publik;
- Fokusin në përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve publike dhe shfrytëzimin e pasurive publike dhe lidhjen e tyre me atë se çka ka për t'u arritur me shpenzimin e tyre;
- Parandalimin dhe zvogëlimin e rreziqeve kryesore për ofrimin e shërbimeve publike, keq menaxhimin e fondeve publike dhe mashtrimin;
- Disponueshmëria e informatave të besueshme, relevante dhe në kohë për të gjithë akterët kryesor në atë se çka është arritur duke i shpenzuar burimet publike.

Dispozitat e pjesës së Auditimit të Brendshëm të ligjit të KBFP-së do të sigurojnë:

- Harmonizim me Standardet Ndërkombëtare për Praktikë Profesionale të Auditimit të Brendshëm (SNPPAB)
- Shfrytëzim efektiv dhe efikas të burimeve të auditimit
- Aranzhime të qëndrueshme të trajnimit për auditorët e brendshëm
- Përmirësim të cilësisë së auditimit të brendshëm

*Përcaktimi i llogaridhënies menaxheriale si shlytës kryesor për përmirësimin e pajtueshmërisë dhe efikasitetit të shpenzimit publik;*

Udhëheqësit e SSP-ve duhet të jenë përgjegjës për - zbatimin e politikave qeveritare dhe menaxhimin e burimeve publike duke nënshkruar KASH-in, buxhetet vjetore dhe raportet financiare të organizatës për të cilat ata janë përgjegjës. Menaxherët e programeve duhet të jenë përgjegjës dhe japin llogari për ofrimin e shërbimeve. Paraqitja e Deklaratës së kontrollit të brendshëm duhet të rregullohet si pjesë e raportit financiar dhe si materializim i llogaridhënies menaxheriale.

*Fokusin në përdorimin efikas dhe efektiv të burimeve publike dhe shfrytëzimin e pasurive publike dhe lidhjen e tyre me atë se çka ka për t'u arritur me shpenzimin e tyre;*

Udhëheqësit e SSP-ve duhet të jenë përgjegjës për paraqitjen e kontrollit të shëndoshë dhe sistematik ndaj inputeve dhe burimeve, përfshirë ndryshimet në ndarjen e detyrave, kompetencave, autoritetit dhe llogaridhënies për shpenzimin e qëllimshëm të fondeve publike.

Udhëheqësit e SSP-ve duhet të caktojnë rishikime të rregullta të kontrolleve ekzistuese, vlerësimin e përshtatshmërisë dhe efektivitetit të tyre dhe propozon masa për adresimin e dobësive të identifikuara.

*Parandalimin dhe zvogëlimin e rreziqeve kryesore për ofrimin e shërbimeve publike, keq menaxhimin e fondeve publike dhe mashtrimin;*

Udhëheqësit e subjekteve të sektorit publik, zyrtaret kryesor administrativ dhe zyrtaret kryesor financiar të duhet të bëhen përgjegjës për menaxhimin e rrezikut të kërcënimeve të tilla si buxhetim jo në pajtueshmëri, dhe shpenzime e hyrje në obligime kontraktuale që shpijnë në detyrime të papaguara, borxhe, dhe ruajtje të dobët të pasurive dhe themelimin e procedurave të menaxhimit të rrezikut.

Duhet të rregullohet raportimi për parregullsi në kuadër të organizatës dhe përtej saj, si parakusht për raportim efektiv dhe efikas të sistemit të MFK-së.

*Disponueshmëria e informatave të besueshme, relevante dhe në kohë për të gjithë akterët kryesor në atë se çka është arritur duke i shpenzuar burimet publike.*

Obligimi dhe përmbajtja e raporteve të MFK-së të dorëzuara dhe të publikuara nga SSP-të dhe MF, duhet të rregullohet, në mënyrë që të jetë në përputhje me kërkesat e standardeve të aplikueshme dhe praktikave më të mira për transparencë, besueshmëri dhe plotësi.

## *Harmonizimi me Standardet ndërkombëtarë për praktikë profesionale për auditim të brendshëm (SNPPAB)*

Dispozitat ligjore për auditimin e brendshëm duhet të pasqyrojnë kërkesat të standardeve të auditimit të brendshëm të pranuar ndërkombëtarisht e të aplikueshme për Kosovën dhe rekomandimet e Drejtorisë së Përgjithshme për Buxhet e Komisionit Evropian lidhur me sigurimin e cilësisë, parimeve etike dhe rolin këshillëdhënës të auditimit të brendshëm. Pavarësia funksionale e njësisë së auditimit të brendshëm, objektiviteti individual i auditorëve të brendshëm, veprimeve në rast të parregullsive të identifikuar dhe dyshimeve për mashtrim duhet të rregullohen. Përkufizimet e mashtrimit, parregullsive, konfliktit të interesave duhet të paraqiten.

### *Shfrytëzimi efektiv dhe efikas i burimeve të auditimit*

Themelimi i funksionit të auditimit të brendshëm duhet të ri definohet gjithashtu edhe baza për caktimin e kritereve të reja për themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm. Objektiva është të kemi 95% të buxhetit total përfshirë buxhetin shtetëror dhe komunal të mbuluar nga funksioni i auditimit të brendshëm, që njësitë e auditimit të brendshëm të kenë personel të duhur që mund të jenë në përputhje me standardet dhe zvogëlimin e mundësisë për themelimin e funksionit të auditimit të brendshëm me nga një auditor të vetëm deri në nivelin minimal. Objektiva gjithashtu është rishpërndarja dhe optimizimi i burimeve njerëzore në dispozicion.

### *Aranzhimet e qëndrueshme të trajnimit për auditorët e brendshëm*

Kërkesat për themelimin dhe mirëmbajtjen e qëndrueshme të skemës së trajnimit për auditorët e brendshëm duhet të definohet së bashku me rolin e ministrit të Financave dhe NJQH-në, dhe sigurimin e çështjeve logjistike për zbatimin e tyre.

### *Përmirësimi i cilësisë së auditimit të brendshëm*

Dispozitat që përcaktojnë zbatimin e detyrueshëm të qasjes së bazuar në rrezik në punën e auditimit të brendshëm dhe ofrimin e shërbimeve këshillëdhënëse për menaxhmentin, nuk duhet të kenë alternativë. Obligimi i menaxhmentit për të marrë pjesë në planifikimin strategjik dhe vjetor të auditimit të brendshëm gjithashtu duhet definuar së bashku me përgjegjësitë për zbatimin e rekomandimeve të auditimit të brendshëm.

Duhet të saktësohen nivelet e ndryshme të sigurimit të cilësisë nga drejtori i Njësisë së Auditimit të Brendshëm, nga Njësia Qendrore Harmonizuese dhe Vlerësimi i Jashtëm.

## **4. Opsionet për kornizën ligjore**

Tri opsionet janë rishikuar në mënyrë që të përmirësohet korniza rregullatore për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike dhe këto janë listuar më poshtë:

4.1. Ndryshimi i LMFP (për çështjet e MFK-së) dhe ndryshimin apo madje nxjerrjen e një LAB-i të ri sipas Planit të Veprimit të Strategjisë së KBFP-së;

4.2. Hartimi i ligjit të veçantë për KBFP që do t'i përfshijë të gjitha këta tre komponentë të KBFP-së;

4.3. Zhvillimin dhe ndryshimin e akteve nën ligjore.

**Opsioni i parë** - tashmë është analizuar gjatë muajit korrik – tetor 2015, kur ministri i Financave, Njësia Qendrore Harmonizuese së bashku me projektin e KBFP-së të financuar nga BE e hartoi propozimin e ndryshimeve të LMFP dhe hartoi propozimin e LAB-it të ri. Ky opsion gjithashtu parashikohet në Strategjinë e KBFP-së 2015-2019.

Bazuar në analizat, është konkluduar se LMFP nuk mundet të ndryshohet, meqë përmbajtja aktuale është përgatitur të shërbej nën kushtet kur procesi i MFP-së në vend ishte në themelimin e sipër. Tashti, ka kërkesa të reja për MFP-në për shkak të rolit të ndryshuar të palëve kryesore të brendshme dhe të jashtme, përfshirë institucionet financiare të BE-së dhe ato ndërkombëtare. Është shumë e mundshme që Qeveria e Kosovës do të duhet të përgatis një LMFP të ri dhe kjo do të merr ca kohë.

Pasi që Strategjia e KBFP-së nuk mund të zbatohet pa e ndryshuar legjislacionin primar, është e këshillueshme që të merret parasysh një ligj i veçantë për KBFP-në, i cili do të rregulloj të gjitha tri komponentët e KBFP-së.

**Opsioni i dytë** - përgatitja e ligjit të veçantë të KBFP-së për përfshirjen e të gjitha elementeve të konceptit të KBFP-së në një Ligj është marrë gjithashtu parasysh gjatë përgatitjes së Strategjisë së KBFP-së 2015-2019 për të cilën edhe Drejtoria e Përgjithshme për Buxhet e Komisionit Evropian ofroi opinion pozitiv dhe e përkrah këtë qasje.

Përfitimet nga ky opsion janë në vijim:

- Bazë e fortë ligjore për zbatimin e përgjithshëm dhe të harmonizuar të KBFP-së;
- Status adekuat ligjor për themelimin e MFK-së dhe AB-së;
- Status adekuat ligjor për fuqizimin e MF-së dhe NJQH-së për shtyrjen e ndryshimeve në proceset e MFP-së dhe në mënyrën e organizimit dhe të punës në administratën publike;
- Nivel më i lartë i përgjegjësisë për zbatimin dhe implementimin e rregulloreve të MFK-së për të gjitha palët kryesore relevante;

Praktika e shumicës së vendeve (përfshirë vendet candidate, potencialisht candidate dhe shtetet anëtare të reja) është që dispozitat e KBFP-së janë vendosura në një ligj të veçantë, e jo si pjesë ligjit bazik të buxhetit apo ligjit bazik të financave publike.

Në këtë fazë të zhvillimit të KBFP-së në Kosovë, do të ishte më e përshtatshme që të kemi një ligj të KBFP-së i cili do t'i përfshinte të gjitha tri komponentët (MFK, AB dhe

NJQH). Do të jetë më e përshtatshme për të përkufizuar rolin dhe detyrat e NJQH-së në ligjin e veçantë (meqë NJQH tash i mbulon të dy komponentët), do të jetë më mirë për përcaktimin e rolit dhe detyrave të Këshillit të KBFP-së (i cili duhet gjithashtu të mbuloj çështjet e MFK-së dhe AB-së), dhe meqë zhvillimi i AB-së ka lidhje me zhvillimin e MFK-së, do të ishte e dobishme t'i kemi këto dy komponentë të përfshira në një Ligj, për t'i treguar e përkufizuar ndër relacionet. Të gjitha çështjet e hollësishme për zbatimin e MFK dhe AB-së rregullohen përmes akteve sekondare apo Udhëzimeve Administrative. Në linjë me këtë, Rregulli aktual i Thesarit nr.1 për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, duhet të ndryshohet, sipas ligjit të ri të KBFP-së.

Ligji i KBFP-së do të fuqizoj pronarin e reformës së KBFP-së - ministrin e Financave dhe njësinë ekzekutive - NJQH-në me autoritetin adekuat dhe fuqinë për zbatimin e menaxhimit të rrezikut, paraqitjen e kontrolleve adekuate ndaj inputeve dhe burimeve dhe imponimin e raportimit adekuat për rezultatet financiare dhe gjendjes financiare të Subjekteve të Sektorit Publik.

Korniza ligjore për KBFP duhet të adresoj:

- **Mbulimin e kufizuar të fushave të KBFP-së:** ligji duhet të siguroj zbatimin e kërkesave të KBFP-së në të gjitha subjektet e sektorit publik dhe siguron përfshirje të të gjitha fondeve dhe pasurive publike. Në legjislacionin aktual, mbulohen vetëm organizatat qendrore, lokale dhe një pjesë e ndërmarrjeve publike.
- **Konceptet e KBFP-së mungojnë/dhe apo nuk janë të definuar mirë:** ashtu siç pohohet në dokumentet e rëndësishme të BE-së: ligji duhet t'i përmbaj përkufizimet lidhur me konceptin e KBFP-së - Llogaridhënies menaxheriale, Subjektet Publike, akterëve kyç të MFK-së dhe terminologjia lidhur me funksionin e AB-së. Legjislacionit aktual i mungojnë këto, janë të vjetruara apo nuk janë përkatëse për temën.
- **Nevoja për harmonizim me standardet e fundit për Kontrollin e Brendshëm dhe Auditimin e Brendshëm:** Ligji duhet të adresoj nevojat për harmonizim të mëtejme dhe përmirësimet e fundit të standardeve ndërkombëtare.
- **Mosfunksionimi i komitetit këshillëdhënës të KBFP-së:** Ligji duhet të përcaktoj rolin dhe funksionin e këshillit të KBFP-së, si këshilltar i ministrit të Financave për çështjet e KBFP-së, për masat që duhet të ndërmerren për zbatimin e Strategjisë së KBFP-së, korniza ligjore për financat publike dhe përmirësimi i sistemit të kontrollit të brendshëm në sektorin publik.
- **Klasifikimi organizativ dhe hierarkia në legjislacionin aktual të financave publike që mungon apo nuk është relevante:** Ligji duhet të përcaktoj hierarkinë organizative si parakusht për themelimin e llogaridhënies menaxheriale dhe zbatimin e saj në praktikë. Përveç kësaj, klasifikimi është parakusht për përmirësimin e planifikimit të aktiviteteve organizative,

realizimit, raportimin për objektivat, aktivitetet, treguesit e performancës dhe monitorimin e tyre.

- **Llogaridhënia menaxheriale nuk është e definuar në mënyrë adekuate në legjislacionin primar:** Ligji duhet të adresoj llogaridhënien menaxheriale, duke i definuar akterët kyç në procesin e MFK-së, përgjegjësitë e tyre dhe linjat e raportimit. Përgjegjësitë duhet të përcaktohen lidhur me parimet e sistemeve të shëndosha të MFK-së siç janë: ndarja e detyrave në propozimin, aprovimin, realizimin dhe regjistrimin e transaksioneve dhe zbatimin e kontrolleve para faktit dhe pas faktit.
- **Funksioni i auditimit të brendshëm:** Ligji duhet të siguroj bazën ligjore për një mënyrë më të arsyeshme të themelimit të funksionit të auditimit të brendsiëm në sektorin publik dhe siguron përfshirje e të gjitha fondeve dhe pasurive publike dhe veçanërisht ato me ekspozim të mundshëm ndaj rrezikut sikur në Ndërmarrjet Publike.
- **Struktura dhe funksionet e NJQH-së janë të ndara në dy ligje të ndryshme,** kjo pengon harmonizimin e detyrave dhe bashkëpunimin në mes të zyrtarëve në kuadër të NJQH-së: Ligji i ri duhet të përcaktoj në mënyrë adekuate rolin dhe kapacitetin e NJQH-së për harmonizim, zhvillimin e metodologjisë së kontrollit të brendshëm, dhe monitorimin e aplikimit të kërkesave të kontrollit të brendshëm në subjektet e sektorit publik. Ajo duhet t'i pasqyroj ndryshimet aktuale në strukturën organizative të Njësisë Qendrore Harmonizuese.

## 5. Arsyeja e propozimit (analiza e opsionit)

Në këtë moment, zbatimi i ligjit të KBFP-së është opsioni më i mirë, meqë ky do t'i sjell në një akt të vetëm të gjitha dispozitat relevante të MFK-së, AB-së dhe NJQH-së. Do të kërkojë nga akterët kryesor që t'i kushtojnë më shumë vëmendje përforcimit të sistemit të kontrollit të brendshëm dhe përmirësimit të auditimit të brendshëm. Ligji i KBFP-së do të bëhet platformë, për NJQH MFK dhe AB, nga i cili ata do të drejtojnë dhe monitorojnë zbatimin e parimeve të COSO dhe SNPPAB-së. Dhe më e rëndësishmja, do ta bëj ministrin e Financave, pronar të të gjithë reformës së KBFP-së dhe do ta fuqizoj në marrjen e vendimeve dhe zbatimin e ndryshimeve.

Një ligj i vetëm i KBFP-së do t'i ndihmoj ministrin të Financave të hap rrugën për hapat tjerë në përmbushjen e kriterëve të Kapitullit 32 Kontrolli Financiar për negociatat me KE-në. Një legjislacion i tillë duhet të konsiderohet nga BE si një sinjal pozitiv për përgatitjen e Kosovës për të marrë gjithashtu edhe përkrahje me buxhet.

## 6. Elementet kyçe të politikës së propozuar

Elementet kyçe të politikës së propozuar që duhet adresuar me Ligjin e ri të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike do të fokusohen në:

- Parimin e llogaridhënies menaxheriale për themelimin e sistemeve të shëndosha të kontrollit të brendshëm dhe përkufizimin e nivelit të llogaridhënies të të gjithë akterëve kryesor të MFK-së në kuadër të një subjekti publik siç është udhëheqësi i subjektit publik, Zyrtari Kryesor Administrativ, Zyrtari Kryesor Financiar dhe menaxherët tjerë të të gjitha niveleve të subjektit (përfshirë nivelin qendror dhe agjencitë vartëse).
- Ndryshimi i filozofisë së menaxhimit duke i caktuar objektivat dhe duke deleguar detyrat nga lart-poshtë dhe llogaridhënia poshtë-lart duke përcjell hierarkinë organizative;
- Përcaktimi i parimeve me të cilat duhet të jetë në përputhje udhëheqësi i SSP-së, ndërsa themelon komponentët e sistemit të MFK-së në kuadër të organizatës. (Mjedisi i brendshëm, caktimi i objektivave, vlerësimi i rrezikut, veprimtaritë e kontrollit, Informimi dhe komunikimi i sistemeve; aktivitetet e monitorimit).
- Kërkesat për lidhjen e politikave dhe objektivave të sektorit publik me planet e veprimit dhe menaxhimin e rreziqeve që prekin arritjen e tyre.
- Procedura për raportimin e parregullsive të punonjësve gjatë kryerjes së detyrave të tyre funksionale.
- Obligimi për t'i trajtuar rreziqet që kërcënojnë objektivat e subjektit dhe problemet tjera të brendshme në takimet e rregullta në të gjitha nivelet e menaxhmentit të subjektit publik, si dhe adresimin e rreziqeve kryesore dhe çështjet tjera strategjike të MFK-së në takimet e rregullta të menaxhmentit të lartë.
- Obligimin e deklaramentit vjetor nga udhëheqësi i SSP-së dhe ZKA për cilësinë e pasqyrave financiare dhe sistemet e kontrollit të brendshëm. Kjo sjell llogaridhënie menaxheriale të shtuar në kuadër të subjektit, ndaj Qeverisë dhe publikut. Deklarata e cilësisë është inputi kryesor na raportin e Ministrisë së Financave për Parlamentin, për cilësinë e informatave financiare dhe sistemet e kontrollit të brendshëm në sektorin publik.
- Bashkërendimi i funksionit të auditimit të brendshëm me SNPPAB në fuqi.
- Shërbimi i auditimit të brendshëm efektiv dhe efikas i ofruar nga personeli i trajnuar dhe i kualifikuar.
- Sigurimi i cilësisë së shërbimit të auditimit të brendshëm që mbulon tërë sektorin publik në Kosovë.

Ligji i ri i KBFP-së nuk do të kërkojë kosto shtesë për zbatimin e tij në krahasim me dispozitat aktuale ligjore lidhur me KBFP-në. Burimet që nevojiten për Ligjin e ri të KBFP-së sigurohen nga buxhetet e planifikuara të Subjekteve të Sektorit Publik, kryesisht për pozitat e pagave, mëditjeve dhe trajnimeve. Gjithashtu, zbatimi i Ligjit



të ri të KBFP-së që për synim ka mënyrën për sigurimin më të arsyeshëm të themelimit të funksionit të auditimit të brendshëm dhe strukturave të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, mund të shpie në zvogëlimin e shpenzimeve aktuale, apo nëse ka nevojë, në rishpërndarjen e shpenzimeve. Pasojat e një qasjeje të tillë do të jenë në total me ndikim financiar neutral në burimet buxhetore, lidhur me koston e zbatimit të Ligjit të ri të KBFP-së.

Ligji i ri i KBFP-së nuk do të krijojë struktura të reja organizative që kërkojnë kosto të reja financiare.

Shpenzimet lidhur me përgatitjen e Ligjit të ri të KBFP-së, siç është organizimi i konsultimit me akterët relevant kryesor, përkthimi dhe shpenzimet e ngjashme do të mbulohen nga Projekti i KBFP-s i financiar nga BE.

**Opsionin i tretë** - ndryshimet në legjislacionin sekondar - zhvillimi dhe/apo ndryshimi i udhëzimeve nuk do të shpie në përmirësimin substancial dhe në zgjidhjen e problemeve kryesore. Problemet dhe mangësitë e identifikuara nuk mund të rregullohen plotësisht me vetëm ndryshimin e akteve nën ligjore dhe mbajtjen e status quos me legjislacionin primar. Ky opsion mund të ofrojë vetëm zgjidhje të pjesshme, ndërsa përmirësimet e qëndrueshme afat gjatë kërkojnë ndryshime në legjislacionin primar.

Meqë, hartimi dhe miratimi i Ligjit të ri për MFPP kërkon më shumë kohë dhe diskutim për qëllimet strategjike të MFP-së në Kosovë, LAB-i kërkon disa ndryshime dhe MFK duhet të zhvendoset në legjislacionin primar, në këtë fazë, veprimi më i realizueshëm do të ishte hartimi i Ligjit primar të veçantë për KBFP-ë. Arandaj, opsioni i vetëm i rekomanduar për Qeverinë e Republikës së Kosovës, mbetet opsioni për hartimin e Ligjit të ri të KBFP-së.

## **7. Pasojat e të gjitha opsioneve të konsideruara**

Hartimi i Ligjit të ri të Kontrollit të Brendshëm të Financave Publike konsiderohet të jetë opsioni më i mirë dhe i rekomandohet Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ndryshimet që do të adresohen me opsionin e rekomanduar pritet të lehtësojnë dhe avancojnë zbatimin e objektivës strategjike për zhvillim të mëtejshëm të KBFP-së së përgjithshme në Kosovë, e vendosur në Strategjinë e re të KBFP-së 2015-2019, si dhe objektivat specifike të vendosura në këtë koncept dokument. Përveç kësaj, efektet që pritet të paraqiten nga ky opsion janë, miratimi dhe zbatimi më i lehtë i rregulloreve të nivelit sekondar. Objektivat e vendosura dhe problemet e identifikuara nuk mund të rregullohen plotësisht duke i ndryshuar vetëm aktet nën ligjore dhe mbajtjen e status quos me legjislacionin primar. Këto opsione mund të ofrojnë vetëm zgjidhje të pjesshme, ndërsa përmirësimet e qëndrueshme afat gjatë kërkojnë ndryshime në legjislacionin primar.

## **8. Vlerësimi i ndikimit financiar për secilin propozim**

Zbatimi i ligjit të KBFP-së duhet të ofrojë kursime buxhetore, meqë ky ligj për shënjestër ka kontrollin e brendshëm dhe auditimin e brendshëm, që nënkupton

parandalimin e shpërdorimit të parave publike dhe shpenzim më efikas të burimeve në dispozicion.

## **9. Konsultimet**

Nevoja për përmirësimin e legjislacionit për Kontrollin e Brendshëm të Financave Publike është identifikuar gjatë përgatitjes së Strategjisë së KBFP-së 2015-2019, dhe është diskutuar ndër anëtarët e Grupit Punues që kanë qenë të angazhuar në hartimin e Strategjisë.

Dobësitë e identifikuara në fushën për kontrollin e brendshëm të financave publike janë konsultuar me gjitha palët e interesit si ; kuvendin zyrtar kryeministrit, Ministrinë, Agjencionet e pavarur, Komunitetin, Departamentin e Buxhetit qendror dhe lokal, Thesarin, si dhe me ekspertë nga komisioni evropian si Departamenti i Përgjithshëm i Buxhetit / Bruksel, dhe SIGMA etj.

## **10. Mënyra e komunikimit të politikës së re në publik**

Me miratimin e koncept dokumentit, Ministria e Financave, sipas rregullave dhe procedurave, do të marr hapa për të komunikuar me të gjitha palët kryesore. Mënyra e komunikimit do të jetë e hapur, opsioni i rekomanduar do të publikohet në ueb faqen e Ministrisë.

Draft ligji i KBFP-së do t'i dorëzohet publikut në mënyrë që të kenë mundësinë për ofrimin e komenteve dhe propozimeve. Gjithashtu do të organizohen debate publike me ekspertë të fushave përkatëse, përfaqësues të institucioneve qeveritare, profesorë universitetesh dhe qytetarë.

Pas miratimit të draft ligjit në Kuvendin e Kosovës, Njësia Qendrore Harmonizuese në kuadër të Ministrisë së Financave, do të kujdeset për komunikimin e Ligjit të ri për Kontroll të Brendshëm të Financave Publike në publik, përmes njoftimeve zyrtare dhe takimeve për disa subjekte apo përmes fushatave të ndryshme për njoftimin e publikut.